



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**  
**Nr. 58, datë 24.04.2019**

**PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARËVE MARGARITA BUHALI DHE FATRI  
ISLAMAJ NGA PROCEDURAT E NDARJES SË ÇËSHTJEVE ME SHORT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 89 shkronja “b” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenet 23, pika 6 dhe 7 dhe 25, pika 3, shkronja “dh” të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, mbi kërkesën e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe të vetë gjyqtarëve Margarita Buhali dhe Fatri Islamaj, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

**VENDOSI:**

1. Përrjashtimin e gjyqtarëve Margarita Buhali, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe Fatri Islamaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, njëkohësisht anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nga procedurat e ndarjes së çështjeve me short në gjykatat respektive, për një afat 3-mujor (tremujor).
2. Përrjashtimin e gjyqtarëve Margarita Buhali dhe Fatri Islamaj nga procedurat e plotësimit të trupave të tjerë gjykues, veç trupit të tyre, për të njëjtën periudhë kohore të përcaktuar në pikën 1, me përrjashtim të rastit kur plotësimi i trupit tjetër gjykues është i detyrueshëm.
3. Ngarkohen Kryetari dhe Kancelari i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Kryetari dhe Kancelari i Gjykatës së Apelit Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**